



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 3490 Prot.

Tiranë, më 01.06 2020

**URDHËR**

Nr. 165, datë 10.06 .2020

**“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR  
PUNËSIMIN E KANDIDATËVE PËR NOTERË”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 8, pika 8 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullave më të hollësishme mbi punësimin e kandidatëve për noterë, si dhe veprimtarisë gjatë periudhës së angazhimit si kandidat pranë noterit.
2. Çdo person që plotëson kushtet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, dhe “d”, dh, të nenit 5, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, mund të bëhet kandidat për noter.
3. Noteri deponon në Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë një kopje të kontratës dhe dokumentacionin ligjor të kërkuar për kandidatët për noterë, brenda 15 ditëve nga momenti i lidhjes së saj me kandidatin për noter.
4. Kandidati për noter regjistrohet në regjistrin përkatës të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe deponon dokumentacionin e kërkuar, jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të punës si kandidat për noter pranë një noteri.
5. Kandidati për noter paraqet pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe të Dhomës Kombëtare të Noterisë dokumentet e mëposhtme:
  - a) 2 fotografi;



- b) Certifikatë personale e marrë jo më herët se tre muajt e fundit;
  - c) Kopjen e dokumentit të identifikimit (pasaportë apo letërnjoftim ID);
  - d) Vërtetimin nga organet e pushtetit vendor lidhur me vendbanimin;
  - e) Kopjen e diplomës së nivelit bachelor dhe diplomës “Master i shkencave” të Fakultetit të Drejtësisë ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, të njësuara në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, të shoqëruara me certifikatat e notave;
  - f) Formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, i plotësuar;
  - g) Vërtetimin nga gjykata dhe prokuroria e vendbanimit se nuk është subjekt në proces për vepra penale;
  - h) Kopjen e librezës së punës;
  - i) Kopjen e kontratës të lidhur mes tij dhe noterit pranë të cilit do të qëndrojë si kandidat për noter;
  - j) Certifikatën e kalimit me sukses të provimit të pranimit në formimin fillestar;
6. Dokumentacioni i paraqitur pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë shqyrtohet brenda 15 ditëve nga administrimi dhe në rast se, konstatohet se dokumentacioni nuk është i plotë, kandidati për noter i lihet një afat 10 ditor për plotësim.
  7. Kandidati për noter lidh një kontratë punësimi me një noter, i cili ka jo më pak se 5 vjet përvojë pune si noter.
  8. Kandidati për noter mund të lidhë kontratë me një noter me moshë maksimale deri në 67 vjeç dhe me të cilin nuk është bashkëshort ose i afërt deri në shkallë të dytë.
  9. Në rast se gjatë kohës që personi qëndron si kandidat për noter, noterit transferohet në një degë tjetër vendore ose ndaj tij jepet një nga masat disiplinore të parashikuara nga neni 26, germa ç), d), dh) të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, kandidati nuk mund të qëndrojë më si i tillë pranë këtij noter. Brenda 2 muajsh nga dita kur masa disiplinore e dhënë është ekzekutuar, kandidati për noter duhet të lidhë kontratë me një noter tjetër të së njëjtës degë vendore për periudhën e mbetur dhe një kopje të saj dërgohet në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Dhomën Kombëtare të Noterisë.
  10. Në rast se masa disiplinore e dhënë është ankimuar nga noterit dhe nuk ka përfunduar shqyrtimi i saj administrativ ose gjyqësor, kandidati për noter do të vijojë të qëndrojë pranë këtij noterit deri sa të përfundojë procesi dhe masa të marrë formë të prerë.
  11. Në rast se gjatë periudhës së qëndrimit si kandidat për noter sëmuret për një afat pa ndërprerje nga 20 ditë deri në 5 muaj, periudha e mëparshme si kandidat njihet, por koha e qëndrimit si kandidat zgjatet për aq kohë sa ai ka qenë i sëmurë.
  12. Në rast se kandidati për noter ka qenë i sëmurë për një kohë më të gjatë se 5 muaj periudha e qëndrimit si kandidat nuk do t’i njihet nëse është më e shkurtër se 1 vit, por ai ka të drejtë të qëndrojë si kandidat duke rifilluar përlllogaritja e afatit nga e para. Paraprakisht, kandidati vë në dijeni dhe i paraqet vërtetimin nga institucionet e shërbimit shëndetësor, Ministrisë së

Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, të cilat bëjnë shënimet përkatëse në regjistra dhe shtesat në dokumentacionin e dosjes personale të tij.

13. Në rast se gjatë periudhës që personi do të qëndrojë si kandidat nuk paraqitet në zyrën noteriale ku është punësuar për një periudhë në vazhdim më të gjatë se 30 ditë, pa asnjë arsye, atëherë koha që ai ka qëndruar si kandidat nuk do t'i njihet për efekt të konkurrimit dhe plotësimi i saj nuk mund të bëhet.
14. Në rast se mungesat pa arsye janë për një kohë më të shkurtër se 30 ditë, ato gjatë gjithë periudhës 2-vjeçare nuk mund të jenë më shumë se 3 muaj në total. Në rast të kundërt koha e qëndrimit si kandidat nuk do të njihet për efekt të konkurrimit, plotësimi i saj nuk mund të bëhet dhe ai nuk mund të vijojë më të qëndrojë si kandidat pranë noterit.
15. Kur nuk janë kushtet e mosnjohjes së periudhës si kandidat sipas paragrafëve të mësipërm, qëndrimi si kandidat zgjatet deri sa të plotësohet afati 2-vjeçar.
16. Kandidatët për noter qëndrojnë në zyrë dhe nën drejtimin e noterit, ndjekin veprimtarinë e zyrës, për një kohë jo më të shkurtër se 8 orë në ditë. Orari i qëndrimit caktohet në kontratën e lidhur mes kandidatit dhe noterit dhe mospërcaktimi i fashës së orarit përbën shkak konsiderimin e aktit me të meta. Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Ministria e Drejtësisë kërkojnë plotësimin e kontratës brenda 10 ditëve.
17. Në rast se kandidati nuk e respekton orarin e parashikuar më sipër, noteri vë në dijeni Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë, të cilat shqyrtojnë rastin dhe kur shkelja vlerësohet e rëndë dhe e përsëritur, Ministria e Drejtësisë e paralajmëron për ndërprerje të procesit të qëndrimit si kandidat për noter dhe bën shënimet në regjistrin e kandidatëve.
18. Në rast se kandidati vijon të mos e respektojë orarin, ndaj tij merret masa e ndërprerjes së kohës së qëndrimit për një afat deri 50 ditë të cilat konsiderohen si mungesa pa arsye, zgjatet koha e qëndrimit si kandidat dhe do të veprohet sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Kjo masë pasqyrohet në regjistrin e kandidatëve. Kur mosrespektimi i orarit ndodh edhe pas masave të mësipërme, Ministria e Drejtësisë bën çregjistrimin e kandidatit nga regjistri përkatës dhe mbylljen e dosjes së tij, duke njoftuar edhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.
19. Gjatë periudhës së trajnimit praktik pranë noterit me të cilin ka nënshkruar kontratën, kandidati për noter shkëputet nga çdo marrëdhënie tjetër pune, përveç asaj shkencore e mësimdhënëse, me synim rritjen e kualifikimit të tij profesional.
20. Marrëdhënia e punës ndërmjet kandidatit për noter dhe noterit pranë të cilit punon është me kohë të plotë dhe rregullohet sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.



21. Noteri siguron që të gjithë kandidatët e punësuar pranë tij marrin një trajnim të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës praktik. Nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e noterit, kandidatët fitojnë njohuri dhe aftësi praktike mbi të gjitha aspektet e veprimtarisë noteriale, mbi fushat e së drejtës të lidhura me noterinë, si dhe njihen me rregullat etiko-profesionale të profesionit.
22. Kandidatët për noter asistojnë noterin lidhur me veprimtarinë noteriale por nuk mund të kryejnë punë ngushtësisht personale me cilësinë e noterit.
23. Puna e kandidatit për noter vlerësohet nga noteri përgjegjës për çdo vit kalendarik duke marrë në konsideratën dhe etikën e treguar gjatë angazhimit në zyrën noteriale.
24. Vlerësimi dorëzohet pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, dhe Ministrisë së Drejtësisë jo më vonë se 31 janari i çdo viti.
25. Brenda 30 ditësh pas përfundimit të periudhës 2-vjeçare, noteri jep mendim me shkrim lidhur me aftësitë profesionale. Ky mendim i dërgohet i mbyllur në zarf Ministrisë së Drejtësisë e cila e depoziton në dosjen e kandidatit. Ministria e Drejtësisë i jep të interesuarit konfirmimin e periudhës së qëndrimit si kandidat për noter.
26. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, noterët dhe kandidatët për noter.
27. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI  
  
ETILDA GJONAJ (SALIÛ)

